

Në bazë të nenit 10 dhe nenit 15 të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10), ndërsa duke vepruar sipas Njoftimit për ndarjen e planifikuar të ndihmës nr. 10-40 të datës 21.02.2025, në përputhje me Programin për mbështetjen e konkurrueshmërisë së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2025, të parashtruar nga Ministria e Ekonomisë dhe Punës nr. 18-294/9 të datës 21.02.2025, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në seancën e mbajtur më 27.03.2025 miratoi këtë

AKTVENDIM

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjatë shqyrtimit të Njoftimit për ndarjen e planifikuar të ndihmës nr. 10-40 të datës 21.02.2025, të parashtruar nga Ministria e Ekonomisë dhe Punës, si dhënës i ndihmës shtetërore, për ndarjen e planifikuar të ndihmës nëpërmjet Programit për mbështetjen e konkurrueshmërisë së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2025, konstatoi se:

Programi për mbështetjen e konkurrueshmërisë së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2025 paraqet skemë ndihme në përputhje me nenin 4 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore.

1. Masa 1 nga pjesa II, fusha A. **Implementimi i politikës industriale** nga Programi për mbështetjen e konkurrueshmërisë së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2025, me titull **Mbështetje për rritjen e konkurrueshmërisë së subjekteve afariste nga industria përpunuese në shumë të përgjithshme prej 5.000.000 denarë**, ku objekt i masës është kompensimi i një pjese të shpenzimeve të subjekteve afariste, edhe atë në shumë prej 50% të shpenzimeve të dëshmuara, por jo më shumë se 500.000 denarë individualisht për secilin subjekt afarist – kërkues i mjeteve, dhe e cila do të realizohet përmes masave në vijim:

1.1 përgatitja e strategjisë për eksport dhe/ose studime për hulumtim të tregut dhe/ose strategji marketingu dhe/ose aktivitete për zhvillimin e brendit për subjektet afariste eksportuese nga industria përpunuese;

1.2 furnizimi, implementimi, certifikimi dhe trajnimi për standarde horizontale; standarde të harmonizuara dhe standarde të tjera dhe dokumente standardizuese nga fusha e industrisë përpunuese, të nevojshme për internacionalizim dhe konkurrueshmëri më të madhe;

1.3 kompensimi i një pjese të shpenzimeve për taksa zyrtare për regjistrim në institucione ndërkombëtare (WIPPO, EPO, EUIPO dhe të tjera) për mbrojtje ndërkombëtare të të drejtave të pronësisë industriale;

1.4 bashkëpunim ndërmjet subjekteve afariste nga industria përpunuese dhe universiteteve për hulumtim, zhvillim dhe inovacione (shfrytëzimi i laboratorëve pranë universiteteve për testime dhe hulumtime, përgatitja e dokumentacionit projektues për përmirësimin e procesit teknologjik dhe produktit, transformim të gjelbër dhe digjital, analiza profesionale, konsultime dhe trajnim të specializuar);

1.5 kompensimi i një pjese të shpenzimeve për transformim digjital të kompanive: zhvillim/furnizim i zgjidhjeve digjitale për mbështetje të biznesit dhe prodhimit, sistem për siguri kompjuterike dhe marketing digjital;

1.6 zhvillimi dhe zbatimi i modeleve qarkore të biznesit dhe/ose sistemeve organizative që çojnë në zvogëlimin e mbeturinave në procesin e mëtejshëm për realizimin e projektit;

1.7 zhvillimi i produkteve të reja nga lëndë të para të ricikluara ose sekondare

paraqet ndihmë **me vlerë të vogël (de minimis)** në kuptim të nenit 5 të Rregullores për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 268/24) dhe e njëjta nuk paraqet ndihmë shtetërore në përputhje me nenin 9 paragrafi (1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore. Ndarja e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis) duhet të bëhet në përputhje me Rregulloren për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis).

2. Masa 2 nga pjesa II, fusha A. **Implementimi i politikës industriale** nga Programi për mbështetjen e konkurrueshmërisë së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2025, me titull **Kompensimi i një pjese të shpenzimeve për akreditimin e laboratorëve, zgjerimin e fushës së akreditimit të laboratorëve ekzistues për testim ose furnizimin e pajisjeve të nevojshme për laboratorë për vendosjen në treg të produkteve cilësore dhe të sigurta, në shumë të përgjithshme prej 3.000.000 denarë**, ku objekt i masës është kompensimi i një pjese të shpenzimeve të subjekteve afariste nga industria përpunuese në lartësi prej 50% të shpenzimeve të dëshmuara, por jo më shumë se 500.000 denarë individualisht për secilin subjekt afarist – kërkues i mjeteve,

paraqet **ndihmë me vlerë të vogël (de minimis)** në kuptim të nenit 5 të Rregullores për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 268/24) dhe e njëjta nuk paraqet ndihmë shtetërore në përputhje me nenin 9 paragrafi (1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore. Ndarja e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis) duhet të bëhet në përputhje me Rregulloren për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis).

3. Masa 3 nga pjesa II, fusha A. **Implementimi i politikës industriale** nga Programi për mbështetjen e konkurrueshmërisë së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2025, me titull **Nxitja e projekteve inovative dhe bashkëpunuese të lidhura me specializimin e mençur, transformimin e gjelbër dhe digjital në kuadër të heliksit të**

katërfishtë, në shumë të përgjithshme prej 5.000.000 denarë, ku objekt i masës është bashkëfinancimi i një pjese të shpenzimeve për iniciativa të reja, për vendosjen e dialogut dhe bashkëpunimit afatgjatë ndërmjet subjekteve afariste nga industria përpunuese, institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve, organizatave joqeveritare dhe palëve të tjera të interesuara, të bazuara në hulumtim, zhvillim dhe inovacione për specializim të mençur, me kompensim të një pjese të shpenzimeve në lartësi prej 75% të projektit, por jo më shumë se 2.500.000 denarë individualisht për projekt dhe me mundësi që masa të realizohet në bashkëpunim me institucione të tjera nëse në programet e tyre të punës mbështesin bashkëpunim ndërmjet shkencës dhe biznesit në hulumtim, zhvillim, inovacione, diversifikim dhe mundësi të reja tregu, si dhe me donatorë,

paraqet **ndihmë shtetërore** në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore, e cila si ndihmë horizontale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 14) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore dhe **si skemë ndihme** në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore, ndahet nga Ministria e Ekonomisë dhe Punës, me ç'rast ndarja e saj lejohet si ndihmë për **projekte hulumtuese dhe zhvillimore** në përputhje me nenin 8 paragrafi (2) pika d) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore dhe nenin 6 të Rregullores për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës horizontale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 03/14).

Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Punës të mbajë evidencë të saktë të ndihmës në përputhje me nenin 15 të Rregullores për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis).

A r s y e t i m

Në përputhje me nenin 10 të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore (në tekstin e mëtejshëm: „Ligji”), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm „Komisioni”) është kompetent për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e çdo forme të ndihmës shtetërore.

Me këtë rast, çdo dhënës i ndihmës shtetërore i përcaktuar në nenin 6 paragrafi (1) të Ligjit, është i obliguar sipas nenit 13 paragrafi (1) të Ligjit, që Komisionit t'i dorëzojë njoftim për çdo plan për ndarjen e ndihmës së re ose ndryshim të ndihmës ekzistuese shtetërore, pa marrë parasysh nëse e njëjta ndahet si ndihmë individuale ose si skemë ndihme.

Duke vepruar në përputhje me obligimin për njoftim, Ministria e Ekonomisë dhe Punës i dorëzoi Komisionit Njoftimin nr. 18-294/9 të datës 21.02.2025 (Nr. ynë 10-40 i datës 21.02.2025) për ndarjen e planifikuar të ndihmës në bazë të Programit për mbështetjen e konkurrueshmërisë së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2025 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 29/25).

Komisioni vlerësoi se Njoftimi i dorëzuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Punës është i rregullt dhe i përmban të gjitha të dhënat e parapara në nenin 14 paragrafi (1) të Ligjit, përkatësisht se njoftimi i tillë për nga forma dhe përmbajtja është në përputhje me Rregulloren për mënyrën

dhe procedurën për paraqitjen e njoftimit për ndarjen e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për ushtrimin e mbikëqyrjes së ndihmës ekzistuese shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 142/11).

Gjatë shqyrtimit të Programit të dorëzuar për mbështetjen e konkurrueshmërisë së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2025, Komisioni i vlerësoi kushtet dhe qëllimin për realizimin e secilit aktivitet të paraparë në të njëjtin Propozim-program, për të përcaktuar nëse aktivitetet e tilla paraqesin ndihmë shtetërore.

Për të përcaktuar nëse një masë e ndërmarrë nga dhënësit e ndihmës shtetërore paraqet ndihmë shtetërore, vlerësohet plotësimi në mënyrë kumulative i katër kritereve në vijim:

- që masa e tillë të përfshijë transferim të mjeteve shtetërore;
- të jetë selektive;
- të paraqesë përparësi ekonomike për përfituesin; dhe
- të ketë ndikim mbi konkurrencën dhe tregtinë.

Programi për mbështetjen e konkurrueshmërisë së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2025 paraqet skemë ndihme në përputhje me nenin 4 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit, pasi që i njëjti paraqet akt juridik në bazë të të cilit, pa obligim për miratim shtesë nga Komisioni, mund të ndahet ndihmë për përfitues të ndihmës shtetërore të cilët nuk janë të përcaktuar paraprakisht në skemë ose çdo akt juridik në bazë të të cilit ndihma që nuk është e lidhur me projekt të përcaktuar saktë mund t'i ndahet një ose më shumë ndërmarrjeve për periudhë të pacaktuar kohore dhe/ose në shumë të pacaktuar.

Masat e përmbajtura në Programin për mbështetjen e konkurrueshmërisë së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2025, fusha A. Implementimi i politikës industriale, Komisioni i analizoi nga aspekti nëse të njëjtat i plotësojnë katër kriteret kumulative të lartpërmendura. Gjatë kësaj analize, Komisioni konstatoi se masa 1 nga pjesa II, fusha A. Implementimi i politikës industriale nga Programi për mbështetjen e konkurrueshmërisë së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2025, me titull Mbështetje për rritjen e konkurrueshmërisë së subjekteve afariste nga industria përpunuese në shumë të përgjithshme prej 5.000.000 denarë, e cila do të realizohet për aktivitetet: 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7, paraqet ndihmë me vlerë të vogël (de minimis) në kuptim të nenit 5 të Rregullores për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 268/24), sepse kompensohet një pjesë e shpenzimeve të subjekteve afariste nga industria përpunuese në lartësi prej 50% të shpenzimeve të dëshmuara, por jo më shumë se 500.000 denarë individualisht për secilin subjekt afarist – kërkues i mjeteve. Kjo tregon se është plotësuar kushti i përmbajtur në nenin 5 të Rregullores për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me vlerë të vogël, sipas së cilës ndihma me vlerë të vogël ekziston nëse shuma e përgjithshme e ndihmës së ndarë për një ndërmarrje nuk tejkalon 300.000 euro për periudhë prej tre viteve të fundit fiskale. Gjithsej për realizimin e kësaj mase janë paraparë 5.000.000 denarë ose 81.301 euro. Prej këtu, kjo masë paraqet ndihmë me vlerë të vogël (de minimis) në kuptim të nenit 5 të Rregullores për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis). Ndarja e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis) duhet të bëhet në përputhje me Rregulloren për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis).

Sipas nenit 9 paragrafi (1) të Ligjit, ndihma me vlerë të vogël (de minimis) nuk është ndihmë shtetërore.

Mbështetja financiare nga kjo masë është e dedikuar për subjektet afariste nga sektori i industrisë përpunuese, në përputhje me Klasifikimin Nacional të Veprimtarive – NKV rev.2.1.

Masa 2 nga pjesa II, fusha A. Implementimi i politikës industriale nga Programi për mbështetjen e konkurrueshmërisë së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2025, me titull Kompensimi i një pjese të shpenzimeve për akreditimin e laboratorëve, zgjerimin e fushës së akreditimit të laboratorëve ekzistues për testim ose furnizimin e pajisjeve të nevojshme për laboratorë për vendosjen në treg të produkteve cilësore dhe të sigurta në shumë të përgjithshme prej 3.000.000 denarë, paraqet ndihmë me vlerë të vogël (de minimis) në kuptim të nenit 5 të Rregullores për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis), sepse një pjesë e shpenzimeve që i kompenson Ministria e Ekonomisë dhe Punës janë në lartësi prej 50% të shpenzimeve të dëshmuara, por jo më shumë se 500.000 denarë individualisht për secilin subjekt afarist – kërkues i mjeteve. Kjo tregon se është plotësuar kushti i përmbajtur në nenin 5 të Rregullores për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me vlerë të vogël, sipas së cilës ndihma me vlerë të vogël ekziston nëse shuma e përgjithshme e ndihmës së ndarë për një ndërmarrje nuk tejkalon 300.000 euro për periudhë prej tre viteve të fundit fiskale. Gjithsej për realizimin e kësaj mase janë paraparë 3.000.000 denarë ose 48.780 euro. Prej këtu, kjo masë paraqet ndihmë me vlerë të vogël (de minimis) në kuptim të nenit 5 të Rregullores për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis). Ndarja e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis) duhet të bëhet në përputhje me Rregulloren për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës me vlerë të vogël (de minimis). Sipas nenit 9 paragrafi (1) të Ligjit, ndihma me vlerë të vogël (de minimis) nuk është ndihmë shtetërore.

Masa 3 nga pjesa II, fusha A. Implementimi i politikës industriale nga Programi për mbështetjen e konkurrueshmërisë së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2025, me titull Nxitja e projekteve inovative dhe bashkëpunuese të lidhura me specializimin e mençur, transformimin e gjelbër dhe digjital në kuadër të heliksit të katërfishtë, ku objekt i masës është bashkëfinancimi i një pjese të shpenzimeve për iniciativa të reja, për vendosjen e dialogut dhe bashkëpunimit afatgjatë ndërmjet subjekteve afariste nga industria përpunuese, institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve, organizatave joqeveritare dhe palëve të tjera të interesuara, të bazuar në hulumtim, zhvillim dhe inovacione për specializim të mençur, me kompensim të një pjese të shpenzimeve në lartësi prej 75% të projektit, por jo më shumë se 2.500.000 denarë individualisht për projekt dhe me mundësi që masa të realizohet në bashkëpunim të Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës me institucione të tjera nëse në programet e tyre të punës mbështesin bashkëpunim ndërmjet shkencës dhe biznesit në hulumtim, zhvillim, inovacione, diversifikim dhe mundësi të reja tregu,

paraqet ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore, e cila si ndihmë horizontale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 14) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore dhe si skemë ndihme në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore ndahet nga Ministria e Ekonomisë dhe Punës, me ç'rast ndarja e saj lejohet si ndihmë për projekte hulumtuese dhe zhvillimore në përputhje me nenin 8 paragrafi (2) pika d) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore dhe nenin 6 të Rregullores për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës horizontale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 03/14). Ndarja e kësaj ndihme duhet të bëhet në përputhje me nenin 6 të Rregullores për kushtet dhe procedurën për ndarjen e ndihmës horizontale. Gjithsej për realizimin e kësaj mase janë paraparë 5.000.000 denarë, përkatësisht 81.300 euro.

Gjithsej për realizimin e të gjitha masave nga pjesa II, fusha A. Implementimi i politikës industriale nga Programi për mbështetjen e konkurrueshmërisë së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2025 janë paraparë 13.000.000 denarë ose 211.382 euro, të siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025, Nënprogrami 11 – Politika industriale, llogaria 637, zërat 462 dhe 464, të dedikuara për implementimin e masave nga Strategjia Industriale e Republikës së Maqedonisë 2018-2027.

Për shkak të sa më sipër, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Në përputhje me nenin 26 paragrafi (3) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit, përveç në rast kur Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës do të urdhërojë kthimin e ndihmës shtetërore të paligjshme ose të keqpërdorur, ndarja e së cilës nuk lejohet.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të aktvendimit. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ